



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 811/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Remzi Dautaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD), paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Remzi Dautaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.11.2013, nga Remzi Dautaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Partia e Drejtësisë (PD), në të cilën pretendohet se në bazë të listave FPR të komunës së Deçanit dhe sekretarit të KQZ-së Xhavit Rexhahmetaj subjekti politik PD ka gjithsejtë 252 vota, ndërsa ueb faqja zyrtare e KQZ-së ka publikuar se PD-ja në Deçan ka vetëm 162 vota. Andaj parashtresesi i ankesës kërkon që të njoftohet lidhur me këtë ndryshim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se *“Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe*

mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 811/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.